

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË GJILAN, në trupin e përbërë nga gjyqtari Vllastimir Dimiq, kryetar i trupit, gjyqtarit të deleguar Agim Ademi, gjyqtar në Gjykatën Komunale në Gjilan, gjyqtarëve porotë Miftar Maloku, Elfete Shala-Llapashtica dhe Abdyl Kadriu, anëtarë të trupit, me sekretaren juridike Verica Gavrilloviq, në lëndën penale kundër të akuzuarit [redacted] nga Gjilani, për shkak të veprës penale vrasja e rëndë nga neni 147.paragr.1 pika 7 KPK, sipas aktakuzës së PPQ në Gjilan PP.nr. 292/2011 të dt.20.12.2011, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, më dt. 28.05.2012, në prezencë të prokurorit publik të qarkut Afrim Shefkiu, të akuzuarit Idriz Hajrizi, mbrojtësit të akuzuarit Ramadan Leka dhe të dëmtuarës Farije Hajrizi, mori dhe publikisht komunikoi

A K T G J Y K I M

I akuzuari [redacted], nga babai [redacted] dhe nëna [redacted], i lindur më dt. 22.06.1966 në fsh. Uglarë, jeton në Gjilan, lagja "Dardania" rr. IX/24, shqiptar, shtetas i Kosovës, i arsimuar, ka të kryer shkollën fillore, i martuar – pa fëmijë, mjeshtër, i gjendjes së dobët ekonomike, i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për veprë tjetër penale, në paraburgim prej dt. 24.11.2011 deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit, por jo më gjatë se deri në skadimin e kohëzgjatjes së dënimit të shqiptuar me aktgjykim të shkallës së parë.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse më datë 21.11.2011 rreth orës 20:30 minuta në lagjen "Dardania" në Gjilan, rr. IX/24 ka privuar nga jeta të ndjerin, vëllain e tij [redacted] nga Gjilani, në atë mënyrë që me dashje, e për shkak të raporteve të përkeqësuar lidhur me pasurinë e paluajtshme, ka hy në shtëpi të tani të ndjerit dhe gjatë konfliktit dhe grindjes, së pari me pjesën e mbrehtë të sëpatës e ka goditur dy herë në pjesën e pasme të kokës, nga të cilat goditje i ndjeri është rrëzuar në dysheme, e pastaj i akuzuari të njëjtit ia vendos një qese najloni në vendin ku ishin shkaktuar lëndimet, e ka nxjerrë nga dhoma dhe shtëpia, duke e tërheqë nëpër oborr e ka hedhur në pusin i cili gjendet në oborr, e ka mbuluar pusin me kapakun e betonit, ka zhveshur gardërobën e përgjakur, e ka futur në qese najloni dhe e ka gjuajtur në lumin "Dobrusha", është larguar nga vendi i ngjarjes dhe ka shkuar në banesën e tij

private, e me punën operative të PK – Njësia Regjionale në Gjilan, më dt. 24.11.2011 është zbuluar dhe arrestuar.

- me çka ka kryer veprën penale vrasja e rëndë nga neni 147 paragr.1 pika 3 KPK.

Gjykata, në bazë të nenit 34,37 paragr.2, 64,65 paragr.1 dhe 73 KPK si dhe nenit 391 KPPK.

E G J Y K O N

Me dënim të burgut afatgjatë në kohëzgjatje prej **25 (njëzetepesë) vitesh.**

Në dënimin e shqiptuar me burg llogaritet koha e kaluar ë paraburgim prej dt. 24.11.2011 deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit, por jo më gjatë se deri në skadimin e kohëzgjatjes së dënimit të shqiptuar me aktgjykim të shkallës së parë.

I akuzuari obligohet që kësaj gjykate në emër të paushallit t'i paguaj 100 € dhe t'i kompensoj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pronëso- juridike, udhëzohet në kontestin civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike e Qarkut në Gjilan, në këtë gjykatë ka ngritur aktakuzë me shkrim PP.nr.292/2011 të dt.20.12.201, kundër të akuzuarit nga Gjilani, për shkak të veprës penale vrasja e rëndë nga neni 147.paragr.1 pika 7 KPK.

Pasi aktakuza ka marrë formën e prerë, është caktuar dhe mbajtur shqyrtimi gjyqësor, dhe gjykata në bazë të provave materiale në shkresa të lëndës dhe gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi për këtë janë përmblusur të gjitha arsyet ligjore.

Prokurori publik i qarkut Afrim Shefkiu, në fjalën e tij përfundimtare theksoi se në bazë të nenit 376.paragr.1 KPPK, ka bërë ndryshimin dhe precizimin e aktakuzës, dhe se dispozitivi i aktakuzës është, me sa vijon:

Sepse më datë 21.11.2011 rreth orës 20:30 minuta në lagjen "Dardania" në Gjilan, rr. IX/24 ka privuar nga jeta të ndjerin, vëllain e tij

nga Gjilani, në atë mënyrë që me dashje, e për shkak të marrëdhënieve të përkeqësuar lidhur me pasurinë e paluajtshme, ka hy në shtëpi të tani të ndjerit dhe gjatë konfliktit dhe grindjes, së pari mizorisht e godet dy herë me sëpatë në pjesën e kokës, duke e rrëzuar në dysheme, e pastaj të njëjtit ia kontrollon xhepat, ia merr shumën e parave prej 4.000 €, e pastaj në gjendjen e tillë të rëndë, tani të ndjerin e mbështjell me qese najloni, duke e tërheqë në mënyrë mizore e ka hedhur në pusin i cili gjendet në oborr, e ka mbuluar pusin me kapakun e betonit, është larguar nga vendi i ngjarjes dhe ka shkuar në banesën e tij private, e me punën operative të PK – Njësia Regjionale në Gjilan, më dt. 24.11.2011 është zbuluar dhe arrestuar.

- me këtë ka kryer veprën penale nga neni 147.paragr.1 pika 3 dhe 7 KPK.

Prokurori publik i qarkut Afrim Shefkiu, pas precizimit të aktakuzës, në tërësi ka mbetur pranë aktakuzës së ndryshuar dhe plotësuar, nga arsyet se gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor, në shqyrtimet gjyqësore, në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë. Gjendja faktike është vërtetuar me pranimin e pjesëshëm të akuzuarit, duke u arsyetuar se në gjendje stresi, për shkak të ofendimeve dhe sulmit të Sadriut, kinse ka humbur kontrollin dhe të njëjtin e ka goditur me sëpatë në kokë, përderisa i njëjti nuk ka sqarime përse të ndjerin e ka hedhur në pusin në oborr dhe për çfarë arsye, gardërobën e vet, të vendosur në qese najloni, e ka hedhur në lumin Dobrusha. Gjendja faktike e përshkruar në aktakuzë është vërtetuar me raportin nga vendi i ngjarjes, skicës së përpiluar dhe fotodokumentacionit në vendin e ngjarjes pas vëzhgimit, ekzaminimit të bërë të ADN të dt. 19.01.2012 me konstatimin mbi vdekjen e të ndj. dhe obduksionit të bërë të ndj. Sadri Hajrizi nga ana e Institutit të Mjekësisë Ligjore në Prishtinë. Nga skica dhe fotodokumentacioni në vendin e ngjarjes qartë shihet se i akuz. ka privuar nga jeta të ndj. e pastaj të njëjtit në kokë, në pjesën e plagës i ka vendosur qese najloni, e ka tërhequr nëpër shtëpi dhe oborr dhe të njëjtin e ka hedhur në pusin i cili gjendet në oborr. Nga konstatimi mbi autopsinë rezulton se vdekja ishte e dhunshme dhe se deri te e njëjta ka ardhur si pasojë e gjakderdhjes së madhe në cipën e fortë të trurit, dëmtimit të indit të trurit, e të gjitha këto janë pasoja të veprimit mekanik me mjet të fortë të mbrehtë. Se i ndj. ka poseduar sasi të konsiderueshme të parave, vërtetohet me anë të raporteve mbi tërheqjen e të hollave në Gjermani sipas datave të cekura në raporte. Nuk është i kontestueshëm pranimi i të akuzuarit se të ndjerin e ka goditë me sëpatë në kokë, se të njëjtin e ka tërheqë nëpër shtëpi dhe oborr, se të njëjtin e ka hedhur në pus dhe pusin e ka mbuluar me kapak të betonit. Me dëshminë e të dëmtuarës – bashkëshortes së të ndjerit, e cila ka përshkruar raportet e të akuzuarit dhe të ndjerit, si vëllëzër që ishin, se i kanë dhënë të holla dhe ia

kanë besuar shtëpinë në ruajtje, kurse i njëjti ia ktheu me vrasje dhe hedhjen e kufomës në pus, e se i ndjeri kishte sasi të konsiderueshme të parave e vërtetoi djali i të ndjerit , atëherë kur është dëgjuar në cilësi të dëshmitarit. Dëshmitari i dëgjuar , në deklaratë ka përshtuar se me telefon celular ka kontaktuar me të afërmit e të ndj. dhe si është angazhuar në zbulimin dhe gjetjen e kufomës së të ndjerit, se me rastin e hyrjes në shtëpi ka vërejtur njolla gjaku nëpër mur, pellgun e gjakut në dysheme, kurse policia e ka gjetur kufomën në pusin që gjendet në oborr. Në bazë të cekurave të mësipërme, propozoi që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të ndëshkohet me dënim meritor, duke vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

Përfaqësuesja ligjore i familjes së dëmtuar, , në fjalën e saj përfundimtare në tërësi e përkrahë fjalën e prokurorit publik të qarkut, i bashkëngjitet procedurës penale kundër të akuzuarit, me propozim që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të ndëshkohet sipas ligjit, e në emër të kërkesës pronëso-ro-juridike kërkon paratë siç ceket në aktakuzën e PPQ.

Mbrojtësi i të akuzuarit, av. Ramadan Leka në fjalën e tij përfundimtare theksoi se i vjen keq për shkak të kësaj ngjarje dhe i shprehë ngushëllime familjes së dëmtuar. Theksoi se, me ndryshimin e akuzës nga ana e prokurorit në kuptim të nenit 376 paragr.1 dhe 3 KPPK, ku pas ndryshimit dhe zgjerimit të aktakuzës, mbrojtësi ka të drejtë që të kërkoj shtyrje të shqyrtimit gjyqësor, për përgatitje të mbrojtjes në kuptim të ndryshimit dhe zgjerimit të akuzës, pa marr parasysh këtë mangësi, i njëjti është i gatshëm të paraqet fjalën e tij përfundimtare. Theksoi se PPQ gjatë paraqitjes së fjalës së tij përfundimtare, në kuptim të nenit 46.paragr.3 dhe 220.paragr.1 KPPK, ka qenë i obliguar të bëj analizimin e provave të shtjelluara, të cilat udhëzojnë në fajësinë e të akuzuarit dhe të cilat janë të rëndësishme për sqarimin e gjendjes faktike në këtë lëndë penale. Në të vërtetë, thëniet nga aktakuza se i akuzuari nga i ndjeri ka marr 4.000 € dhe se për këtë ka kryer vrasjen edhe në dobi të akuzuarit, në kuptim të nenit 3.paragr.2 KPPK si edhe gjatë procedurës nuk është argumentuar se i akuzuari vërtet i ka marr ato të holla, por, vetëm dyshohet se ai e ka bërë këtë. Po ashtu, nuk është vërtetuar thënia e PPQ se pas vrasjes së kryer të njëjtin e ka vendosur në qese najloni, kjo pra nuk është vërtetuar, dhe se i akuzuari nuk ka shkuar me qëllim në shtëpi të dëmtuarit, që të njëjtin ta privoj nga jeta dhe nga i njëjti të merr para. Atëherë, kur ndodhi ngjarja, përveç të ndjerit dhe të akuzuarit, në shtëpi nuk ka qenë askush. Po ashtu, në fillim cekej në aktakuzë se i akuzuari ka marr edhe orën “Armani” por e njëjta më vonë është gjetur në pus dhe asnjëherë nuk është vërtetuar se nga xhepi janë marr 4.000 €, kështu që thëniet e prokurorit nuk mund të ekzistojnë – se i akuzuari me qëllim dhe dashje ka shkuar të privoj nga jeta të dëmtuarin. I akuzuari mbrëmjen kritike ka shkuar në shtëpi të ndjerit që të

bisedoj me të lidhur me pasurinë e trashëguar dhe të kërkoj pjesën e tij ideale nga patundshmëria. Nuk është kontestuese se të afërmit dhe familjarët e të ndjerit, rëndë e kanë përjetuar kryerjen e kësaj veprë penale. Në bazë të deklaratës së të akuzuarit, theksoi se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës ka pranuar se vërtetë e ka kryer veprën penale të vrasjes, por se nuk i ka marr të hollat në shumë prej 4.000 €, e për këtë nuk ka edhe prova, përveç të 20 € të cilat i ka marr mbi tavolinë. I akuzuari ka pranuar fajësinë për vrasje të rëndë të vëllait të tij, si akt ligjor dhe moral, kështu që mbrojtjes nuk i mbetet tjetër veç se të kërkoj që të akuzuarit t'i shqiptohet dënimi sa më i butë, pasi që konsideron se në anën e të akuzuarit qëndrojnë rrethana lehtësuese të cilat do të kenë ndikim për një dënim të lehtë dhe më të butë. Në mes të akuzuarit, të ndjerit dhe vëllezërve të tyre nuk kanë qenë të rregulluara marrëdhëniet pronësore juridike të pasurisë në fsh. Uglarë dhe në qytetin e Gjilanit. Patundshmëria nuk ka qenë e ndarë mes vëllezërve, e këtë e kanë vërtetuar edhe dëshmitarët e dëgjuar. E dëmt. – bashkëshortja e të ndjerit, e di se bashkëshorti i saj, deri sa ishte në jetë, nuk i ka pasur të rregulluar marrëdhëniet pronësore me vëllezërit e tij. Deklaratën e tillë e kanë vërtetuar dëshmitarët dhe . Sipas mendimit të mbrojtjes, deri te vrasja ka ardhur pa qëllim dhe paramendim, e për shkak të mos rregullimit të marrëdhënieve pronësore, e kjo qartë shihet në bazë të provave, vërtetimit mbi gjendjen pasurore se e tërë pasuria në fsh. Uglarë dhe në Gjilan evidentohet në emër të ndj. dhe se pasuria është regjistruar në vitin 2006, pa u zhvilluar procedurë trashëgimore. I akuzuari, i ndjeri dhe anëtarët tjerë të familjes në fillim jetonin në të njëjtën shtëpi, por për shkak të rrënimimit dhe ndërtimit të shtëpisë së re, i akuzuari dhe vëllezërit e tij kanë dalë nga ajo shtëpi dhe kanë jetuar nëpër shtëpi private, me qira. Pas përfundimit të ndërtimit të shtëpisë së re, i akuzuari ka kërkuar që të kthehet në atë shtëpi, e mu për këtë, ka pasur edhe konflikt verbal dhe fizik në mes të akuzuarit dhe të ndjerit. Të gjitha këto raporte të parregulluara kanë ndikuar në gjendjen ekonomiko-sociale të akuzuarit, dhe për shkak të gjendjes së tillë ka filluar të rritet urrejtja ndaj të ndjerit, e mu për këto arsye ka ardhur deri te sulmi. Gjatë procedurës nuk është argumentuar se i akuzuari Idriz ka pasur qëllim dhe se për këtë arsye ka shkuar për ta privuar nga jeta vëllain. Megjithatë, mbrëmjen kritike gjatë zhvillimit të bisedës lidhur me patundshmëritë, ka ardhur deri te ofendimi dhe fjalosja, e për këtë arsye i akuzuari u gjet në një gjendje të keqe mentale, pra për shkak të sulmit dhe ofendimeve i akuzuari ka privuar nga jeta të ndj. dhe se në gjendje të tillë është gjetur pa fajin e tij, i cili gjatë tërë procedurës ka shprehur pendim të thellë. Theksoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë veprime të kryerjes së veprës penale nga neni 148 KPK, vrasje në gjendje të çrregullimit shpirtëror, e nga këto arsye ka bazë për aplikim të nenit 64,66 paragr.1 dhe 67 paragr.1 KPK, që kundër të akuzuarit të shqiptohet dënim sa më i butë, sepse edhe me dënim më të butë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 34 KPK.

I akuzuari [redacted], në fjalën e tij përfundimtare theksoi se në tërësi e përkrahë paraqitjen e mbrojtësit të tij, konsideron se ka gabuar që ka privuar nga jeta vëllain e tij, e nga gjykata kërkoi që ta dënoj sa më butë.

I akuzuari [redacted] duke u mbrojtur thekson se ditën kritike më dt. 21.11.2011 ka shkuar te vëllai i tij, i ndj. [redacted], për të biseduar me të njëjtin lidhur me pasurinë e përbashkët. Së pari filluan të bisedojnë jashtë shtëpisë, në oborr, por kur hynë në shtëpi i ndjeri i tha se nga pasuria nuk do të merr asgjë, sikur edhe vëllezërit tjerë, dhe nëse ndahet nga gruaja mund të kthehet dhe të jetoj në shtëpi. Theksoi se pas kësaj i ndjeri filloi të shaj, ofendoj, të shaj bashkëshorten e këtij, dhe kur i akuzuari ia tërhoqi vërejtjen që të mos shaj dhe të mos sillet kështu, nga i ndjeri është goditur me grusht në pjesën e brinjëve, ndërsa i akuzuari pas kësaj e ka shtyrë, dhe pasi që i ndjeri përsëri e ka sharë dhe ka dashur që të merr sëpatën, e ka kapur të ndjerin për dore dhe në atë moment ia ka marr sëpatën nga dora, ku pastaj vetëm e ka pa të përgjakur në dysheme, atëherë ka humbur kontrollin mbi veten dhe nuk e di sa çfarë ka bërë më tej. Pasi që vërejtji se i ndjeri ishte në dysheme të njëjtin e tërhoqi dhe e hodhi në pus, i cili pus gjendet në oborr. Pas kësaj ka braktisur shtëpinë e tani të ndjerit [redacted]. Theksoi se, kur ka shkuar në banesën e tij ka zhveshur gardërobën që kishte në trup, e vendosi në qese najloni dhe e hodhi në lum. [redacted] se nuk e ka kontrolluar dhe bastisur gardërobën të cilën i ndjeri e kishte të veshur, kështu që nuk e di se çfarë shume të hollash kishte i ndjeri në xhepin e tij para vrasjes. Nuk është e vërtetë se pas vrasjes nga i ndjeri ka marr 4.000 €. Rasti ka ndodhur rreth orës 20:00 dhe sa i kujtohet, pas ngjarjes, në shtëpi ka qëndruar 10-15 minuta. Para se të nxjerr trupin e të ndjerit nga dhoma, të njëjtin ia vendosi qesen e najlonit në pjesën e pasme të kokës, në vendin ku i kishte plagët e shkaktuara nga sëpata. Theksoi se të ndjerin e ka goditur dy herë me pjesën e topitur të sëpatës në pjesën e pasme të kokës – qafë, dhe se i ndjeri nga goditjet e pësura është rrëzuar në dysheme. Pasi që i ndjeri është rrëzuar në dysheme, në dhomë i gjeti dorëzat të cilat i vendosi në duar, e pastaj të ndjerin e nxori nga shtëpia duke e tërheqë deri te pusi, ku edhe e hodhi dhe me kapak mbuloi pusin. Pas doli nga shtëpia i mori 20 € të cilat ishin mbi tavolinë, e pse e bëri këtë, nuk e di. Me të ndjerin [redacted] ishin vëllezër dhe i njëjti vazhdimisht e ka sharë dhe ofenduar. Theksoi se, para ngjarjes kritike nuk ka pasur raporte të mira me të ndjerin, se në Gjermani ka jetuar si azilkërkues që nga viti 1996-2002 dhe vendqëndrimin e kishte në Duseldorf. Në fillim nuk ka ardhur te tani i ndjeri [redacted], i cili po ashtu ka punuar në Gjermani, i ndjeri me familje ka jetuar në qytetin Leverkusen. Pasi që i ndjeri ishte me familje në Gjermani, ka jetuar në shtëpinë e saponduar, sepse i ndjeri ia kishte besuar çelësin dhe shtëpinë në përkujdesje. Përderisa e kishte shtëpinë në përkujdesje në të njëjtën shtëpi është kryer vjedhje dhe janë nxjerr sende nga shtëpia, e edhe me dy persona tjerë, nga shtëpia ka

marr dy armë, për të cilat armë është duke u zhvilluar procedurë pranë Gjykatës së Qarkut në Gjilan. Theksoi se pasuria nuk ka qenë pronë e të ndjerit, por e babait të tyre dhe se babai i tij nga pasuria ka shitur 10 ari, e paratë ia ka dhënë të akuzuarit, ndërsa i akuzuari vetë ka shitur edhe 10 ari. Të hollat të cilat i ka pranuar nga babai me rastin e shitjes së arës i ka shfrytëzuar për të shkuar jashtë vendit, ndërsa të hollat të cilat i ka marr nga shitja e arës i ka deponuar për rinovim të shtëpisë së vjetër në vitin 2004. Mbrëmjen kritike nuk e ka ditur se a ka pasur i ndjeri të holla në gardërobën e tij. Vrasja ka ndodhur në shtëpi, në një dhomë të vogël. Me rastin e goditjes me sëpatë, i ndjeri ishte i kthyer me shpinë kah i akuzuari. Mbrëmjen kritike, për shkak të fjalosjes me të ndjerin dhe pasi i njëjti i ka thënë se nuk do t'i jep pasuri, ka humbur shpresën për jetë dhe kontrollin, mori sëpatën e cila gjendej në korridor të shtëpisë dhe me të njëjtën goditi të ndjerin në pjesën e kokës, përderisa po qëndronte në korridor. Theksoi se nuk e ka të njohur se kush e ka blerë truallin në të cilin ka qenë shtëpia e vjetër, ndërsa vëllezërit e tij i kanë thënë se atë truall e kanë blerë të gjithë së bashku. Babai i tij i ndjerë në atë truall ka ndërtuar shtëpinë, e ky, pas ndërtimit të shtëpisë, ishte 7-8 vjeç. Mbrëmjen kritike vetë ka shkuar te tani i ndjeri, për të biseduar lidhur me pasurinë. Theksoi se kinse i ndjeri i ka thënë se duhet të shkurorëzohet nga bashkëshortja, se mund të vij vetë dhe të jetoj në shtëpi dhe se bashkëshortja e tij nuk do të merr asgjë. Nuk e di arsyen e saktë përse i ndjeri sillej ashtu, por konsideron se i ndjeri nuk ka mundur të duroj, pasi që nëna e bashkëshortes së këtij ishte "boshnjake". Theksoi se deri në vitin 2006 ka jetuar në shtëpi të vjetër, e më vonë është shembur shtëpia e vjetër, dhe në vendin e saj i ndjeri ka ndërtuar shtëpinë e re. Pas shembjes së shtëpisë së vjetër, ky ka braktisur këtë vend dhe ka shkuar në lagjen e "Balecit", ku ka banuar privatisht. Ceku pastaj se me vëllezërit ka pasur marrëveshje gojore që pas përfundimit të shtëpisë të gjithë të kthehen në atë shtëpi. Theksoi se ka punuar në ndërtimin e shtëpisë si punëtor, pasi që kryesit e punëve ishin tjerë, e për këtë i kanë paguar. Më vonë ka kuptuar se i ndjeri Sadri, patundshmërinë e kishte regjistruar në emrin e tij atëherë kur është kthyer nga Gjermania dhe kur ka filloj të shfrytëzoj pensionin. Theksoi se mbrëmjen kritike i ndjeri Sadri e ka goditur në pjesën e fytyrës, se i pari mori sëpatën e cila ishte në korridor, ia rrëmbeu sëpatën dhe me të njëjtën dy herë e goditi në pjesën e kokës. Në hetime ka pohuar se gjendja e tij para momentit kritik ishte e mirë, se nuk ka përdorë barna e as nuk ka shkuar në kontroll mjekësor. Me rastin e marrjes në pyetje nga ana e kryetarit të trupit gjykues, i akuzuari ka deklaruar se të ndjerin e ka goditur dy herë me pjesën e topitur të sëpatës, se i akuzuari është rrëzuar në dysheme pas goditjes së parë me sëpatë, se është rrëzuar në shpinë dhe se goditjen e dytë ia ka shkaktuar atëherë kur i ndjeri ishte në dysheme. Pas hedhjes së kufomës në pus, nuk e ka verifikuar se a është fundosë kufoma në ujë apo ka mbetur në sipërfaqe të ujit, thellësia e pusit është 8 metra, ndërsa niveli i ujit është 2 m prej tokës. Pasi që në

banesën e tij e ka hequr dhe ndërruar gardërobën, ka veshur gardërobë të pastër dhe, pasi që gardërobën të cilën e kishte në kohën e vrasjes e kishte hedhur, në qytet është takuar me mikun e tij dhe të njëjtit i ka thënë se ka privuar nga jeta vëllain e vet, por miku i tij kësaj nuk i ka besuar. Natën, pas vrasjes së kryer, në shtëpinë në të cilën banonte, nuk kanë ardhur pjesëtarët e policisë. Atëherë, kur për herë të parë e sollën në stacionin policor qëndroi 30 minuta dhe pastaj është liruar dhe në polici nuk tregoi se ka kryer vrasje. Po ashtu ka theksuar se deri sa ishte në paraburgim ka pranuar ftesë nga gjykata për konfirmim të aktakuzës. Ka tentuar gjatë vitit 2012 përsëri të shkoj jashtë vendit, por nga Shqipëria e kanë kthyer në vendin ku jeton, pra në Gjilan. Mbrëmjen kritike nuk kishte thikë me veti, e thika nga fotografia në shkresa të lëndës është konfiskuar nga policia, të njëjtën e ka përdorë për të prerë bukën. Pas vrasjes, nga habia, i veshi këpucët e të ndj. Sadri. Pas zbulimit të kufomës në pus, është sjell në stacionin policor dhe është mbajtur në paraburgim.

Gjykata nuk e pranoi pjesën mbrojtëse të akuzuarit, se mbrëmjen kritike ka ardhur deri te konflikti dhe ngatërresa me të ndjerin, e se për shkak të ofendimeve të mëdha të cilat kinse i ka përjetuar mbrëmjen kritike dhe pasi që i ndjeri e kishte goditur me grusht, mori sëpatën e cila ishte në korridor dhe me të njëjtën dy herë goditi të ndjerin në pjesën e pasme të kokës me pjesën e topitur të sëpatës .

Me provat e shtjelluara gjatë shqyrtimit dhe atë me dëgjimin e dëshmitarit është vërtetuar se nuk i kujtohet data e saktë kur në orët e mbrëmjes, nga Gjermania, e kishte thirr vajza e hallës, me emrin Afërdita dhe e kishte lutur që të shkoj lagjen "Gavran" deri te babai i saj, dhe të shikoj përse i njëjti qe tre ditë nuk po lajmërohet në thirrjet telefonike nga jashtë. Me vete e mori edhe vëllain e tij , dhe kur arritën te shtëpia e të ndjerit trokitën në derë dhe dritare, një dritë në shtëpi ishte e ndezur, por askush nuk i është përgjigjur këtyre trokitjeve, dhe me vëllain është kthyer në shtëpi. Pasi u kthye në shtëpi përsëri e thirrën nga Gjermania dhe ky u tha se shtëpia ishte e mbyllur me çelës dhe se askush nuk i është përgjigjur thirrjeve. Rreth orës 21:00 përsëri e thirri Afërdita dhe e luti që të shkoj në Stacionin policor dhe të lajmëroj rastin, dhe pasi e bërë këtë është kthyer mbrapa me pjesëtarët e policisë te shtëpia e të ndj. Sadri. Pasi që dera ishte e mbyllur, policia e theu derën, ku ndihmoi edhe dëshmitari, dhe hynë në shtëpi. Pas hyrjes në shtëpi policia filloi të kontrolloj dhomat, ndërsa dëshmitari me vëllain e tij po prishte përpara në korridor të shtëpisë. Deri sa po bënin bastisje në shtëpi drita ishte e ndezur dhe në një dhomë të vogël nëpër mur kishte vërejtur njolla gjaku e në dysHEME ishte një pellg i madh gjaku, kështu që është dyshuar se i ndjeri është vrarë. Sipas gjurmëve të gjetura në shtëpi dhe oborr, zbuluan se viktima ishte hedhur në pus. Nuk ka dëgjuar e as nuk e ka ditur se i ndjeri kishte probleme me të akuzuarin,

përveç se një herë kishte pasur vjedhje në shtëpi të ndjerit. Mban mend shtëpinë e vjetër në të cilën jetonin i ndjeri me familje, atëherë kur vinte në pushim e në atë shtëpi jeton edhe prindërit e të ndjerit dhe akuzuarit.

Me deklaratën e dëshmitares-të dëmtuarës bashkëshortes së të ndj. , është vërtetuar se e njëjta në kohën e kryerjes së veprës, për shkak të sëmundjes së djalit ka qëndruar në Gjermani, ndërsa bashkëshorti i saj, tani i ndjerë, kishte mbetur në Gjilan, e i akuzuari gjatë natës ka hy në shtëpi dhe ka vrarë të ndjerin, që nga i ndjeri të merr para. Theksoi se deri sa ishte në Gjermani, për shkak të sëmundjes së fëmijës, përherë me të ndjerin kontaktonin me telefon, i ndjeri kërkonte që kjo të kthehet në shtëpi sepse ky nuk mund të qëndroj vetëm, e kjo këtë edhe do ta bënte pasi të shërohej fëmija. Pasi që tre ditë rresht e kanë thirr, e i ndjeri nuk lajmërohej në telefon, e luti nipin e vet , që të shkoj deri te shtëpia e tyre dhe të verifikoj se mos ka ndodh diçka. Dyshonin se të ndjerit i ka ndodhë diçka në gjumë, edhe pse i njëjti ishte i shëndoshë dhe nuk përdorte barna. Megjithatë, i njëjti nga vëllai i tij, të akuzuarit, është privuar nga jeta dhe është hedhur në pus dhe se i akuzuari i kishte marr paratë që kishte me veti, shumën prej 4.000-5000 €. Për vdekjen e bashkëshortit të saj ka kuptuar atëherë kur policia me ftesë të nipit të saj hyri në shtëpinë ku kishte ndodhur vrasja dhe se për këtë arsye kanë ardhur nga Gjermania, për të varrosur të ndjerit. Raportet në mes të bashkëshortit të ndjerë dhe të akuzuarit nuk ishin shumë të mira, pasi që i akuzuari kishte kryer vjedhje në shtëpi të tyre, edhe atë gjatë kohës kur të njëjtit ia kishin lënë çelësin që të kujdeset për shtëpinë. Theksoi se i akuzuari kishte shitur 3 ara në fsh.Uglarë, e pasuria nga kjo arsye nuk është e ndarë, e që për shkak të shitjes së mëhershme, nuk i takon pasuria e cila ka mbetur. Theksoi se i akuzuari nuk ka jetuar në shtëpinë të cilën e kishte ndërtuar bashkëshorti i saj i ndjerë, se kohë pas kohe vinte si mysafir dhe se përherë është pritur dhe shërbyer në mënyrë njerëzore. Theksoi se i akuzuari 7 vite ka jetuar në Gjermani, atje ka jetuar me një femër, por letrat, për të mbetur në Gjermani, nuk i ka rregulluar. Ceku se bashkëshorti i saj asnjëherë nuk ka pasur konflikt me të akuzuarin edhe pse i akuzuari disa herë nga xhepi i ka marrë nga 500 €. Nuk është e sigurt sa para kishte me vete ditën kritike bashkëshorti i saj, pasi që ekziston mundësia që të hollat të tërhiqen edhe nga banka në Gjilan. Kur djali i tyre vinte nga Gjermania binte para të cilat i tërhiqte nga xhirologaria e të ndjerit në Gjermani dhe të njëjtat para ia jepte të ndjerit. Kur erdhën nga Gjermania me rastin e vrasjes së të ndjerit Sadri, para se ta varrosnin, tek i njëjti nuk janë gjetur 4.000 €, të cilat i kishte në xhep të pantallonave, ndërsa 500 € i gjeti djali i saj, atëherë kur të ndjerit, para se ta varrosnin, ia zhveshi gardërobën. Atëherë, kur bashkëshorti i saj i ndjerë qëndronte në Gjilan, i vizitonte motrat e tij, sikur edhe ato të ndjerin, ishin gjashtë fëmijë dhe atë tri motra dhe tre vëllezër. Theksoi se i ndjeri i mbante gjithë familjarët dhe se ka ndodhur që për shkak të obligimeve ndaj

fëmijëve 10 vite të mos vij në Gjilan. Ka jetuar në bashkësi me vjehërrinë dhe kunetët. Shtëpia e re është ndërtuar në vendin ku ishte shtëpia e vjetër – e cila ishte në shitje, përderisa ndërtimin e shtëpisë së re e ka financuar bashkëshorti i saj i ndjerë dhe e njëjta është ndërtuar para 5-6 viteve, e në shtëpinë e vjetër kanë jetuar deri në kohën kur është bërë rrënimi i të njëjtës. Para se të rrënohet shtëpia e vjetër, të gjitha anëtarët që jetonin në të kanë dalë dhe kanë gjetur banesa në qytet në vende të ndryshme. Prindërit e bashkëshortit të saj kanë vdekur para se të bëhet rrënimi i shtëpisë së vjetër. Shtëpia e rrënuar është blerë para 40 viteve, të njëjtën e ka blerë i ndj. me mjetet e tij, e për të nga pasuria nuk ka shitur e as nuk ka marr në fsh. Uglarë. I ndjeri doli në pension 6 muaj para se të vritej dhe që nga dalja në pension vazhdimisht ka jetuar në Gjilan, ndërsa dëshmitarja për shkak të sëmundjes së fëmijës ka shkuar në Gjermani, e i ndjeri kishte mbetur në Gjilan, si pensionist.

Dëshmitari i dëgjuar [emri], djali i të ndjerit, i lindur në Gjermani, deklaroi se prindërit e tij kanë jetuar me vëllezërit dhe se shtëpia e tyre gjendet në Gjilan, lagja “Dardania” nr. 2. Babai i tij i ndjerë ka qenë pensionist dhe nga Gjermania është kthyer para 5-6 muajve, para vrasjes, përderisa me babanë ishte në kontakt të vazhdueshëm përmes telefonit. I njëjti është privuar nga jeta dhe ka njohuri se këtë e ka bërë [emri], se këtë e ka bërë [emri] ka kuptuar nga i afërmi i tij [emri], atëherë kur ka ardhur nga Gjermania, në varrim. Para se të merr vesh dhe të lajmërohej për vrasjen e babait të tij, dy-tre ditë ka tentuar të kontaktoj me të ndjerin, por nuk arriti dot, dhe pasi është lajmëruar nga motra e tij Merdita [emri] se babai i tij është vrarë dhe është hedhur në pus, erdhi në Gjilan. Theksoi se babai i tij ka qenë në raporte të mira me të akuzuarin, se babai i tij, me veti, kishte sasi të mjaftueshme të parave dhe se sa herë që ka ardhur nga Gjermania ka sjell para. Para se ta varrosin, në veshjet e brendshme të babit të tij, gjeti 500 € dhe kartelën e bankës. Babai i tij i ndjerë kishte pasur të veshur tre palë pantallona, se në xhep në pantallonave kishte prej 3.000 – 5.000 € dhe se ato para se ta varrosnin nuk i kanë gjetur te i ndjeri. I akuzuari Idriz e ka ditur se i ndjeri ka për të pranuar shumë prej 100.000 € nga kursimet që kur punonte në Gjermani dhe se i ndjeri ato para mund t’i tërheqë gjatë vitit 2010 e tutje. Theksoi se babai i tij i ndjerë i ka ndihmuar të akuzuarit [emri], e ka lejuar që të banoj në shtëpi, i kanë ndihmuar në Gjermani dhe supozon se të hollat që kishte i ndjeri me veti, i ka marr i akuzuari [emri]. Ceku se, para vrasjes e pas pensionimit i ndjeri ka jetuar në Kosovë, me bashkëshorten dhe një djalë, e për shkak të sëmundjes këtë fëmijë e kanë dërguar në Gjermani, ndërsa i ndjeri kishte mbetur i vetëm në shtëpi. Theksoi se nuk ka pasur pasuri e cila është dashur të ndahet dhe se babai i tij vet e ka blerë shtëpinë e vjetër në Gjilan, e pastaj ka ndërtuar shtëpinë e re. Ceku se, çështja lidhur me pasurinë nuk ka qenë e rregulluar, e sa herë që vinte nga Gjermania të ndjerit i sillte para. Theksoi se babai i tij

në shtëpi të vjetër jetonte me vëllezërit Idrizin e Ismetin dhe bashkëshortet e tyre, po ashtu, në shtëpi të vjetër kanë jetuar edhe prindërit e të ndj. Sadri dhe se të gjithë këta i ka mbajtur babai i tij i ndjerë. Pasi që i ndjeri doli në pension dhe përderisa punonte në Gjermani, të hollat i ka mbajtur në bankë e ato të holla ka mundur t'i tërheqë edhe në Kosovë, në vendin ku jetonte. Theksoi se, pas varrimit ka bërë verifikim në bankë në Gjermani, e në xhironlogari të ndjerit ishin rreth 50.000 €. Prindërit e babait të tij të ndjerë, pra gjyshi i tij ka vdekur gjatë vitit 1999-2000 ndërsa gjyshja gjatë vitit 2005-2006. Pasi kuptoi për vrasjen erdhi nga Gjermania dhe në gardërobën e të ndjerit gjeti 500 € dhe kartelën e bankës. Pasurinë të cilën e kishte shitur i akuzuari, ishte pronë e babait të tij të ndjerë.

Dëshmitarja theksoi se i akuzuari e ka shitur pasurinë të cilën e kishte, se vëllain e tij e kishte vrarë për shkak të hollave edhe pse i ndjeri e kishte mbajtur gati 40 vite. Kanë pasur raporte të mira mes veti, pasi që përherë i jepte para për mbajtje. Kur i ndjeri shkoi në Gjermani, të akuzuarit i linte para dhe shtëpinë në përkujdesje, kurse i akuzuari i merrte sendet nga shtëpia dhe i shiste. Në shtëpinë e vjetër jetonte e gjithë familja dhe atë, prindërit e tyre deri sa ishin në jetë, pastaj vëllezërit e saj, e kur e rrënuan shtëpinë e vjetër ndërtoi shtëpi të re, pra, të gjithë kanë jetuar në shtëpi të vjetër. Kur u ndërtua shtëpia e re, vëllezërit e tani të ndjerit nuk janë kthyer në shtëpi të re, jetonte në qytet, por nuk e di se ku. Nuk e di përse Idrizi nuk është kthyer në shtëpi të re, dhe nuk e di se çfarë raporte kishte në mes të ndj. dhe bashkëshortes së të akuzuarit Idriz. Theksoi se kishte kryer vrasjen, i ka marr të hollat dhe të ndjerin e kishte hedhur në pus. Ka dëgjuar se i ndjeri është privuar nga jeta për para. Nga toka dhe pasuria në fsh. Uglarë të cilën e ka shitur i akuzuari Idriz, të hollat i ka shpenzuar vet, e të njëjtit materialisht i ka ndihmuar i ndj. më tepër se 40 vite. Për vrasje ka kuptuar pasi që i ndjeri është nxjerrë nga pusi, ku edhe ka marrë pjesë në varrimin e të ndj. Nuk e ka të njohur se a është zhvilluar ndonjë kontest në mes të ndjerit dhe të akuzuarit lidhur me pasurinë.

Në procesverbalet e lexuara të dëshmitarit 1, i dëgjuar në hetime PP.nr. 292/2011 të dt. 15.12.2011, ceket se ishte ditë e hënë e muajit nëntor të vitit 2011 dhe atë se data ishte 21 nëntor. Pasi që punon si taksist i ka ndihmuar një udhëtar që gjësendet t'i vendos në bagazh të veturës së taksisë "Sharri" dhe përnjëherë i është ofruar tani i akuzuari duke tentuar të bisedoj me dëshmitarin, lidhur me bashkimin e serishëm me bashkëshorten e tij, përndryshe motër e dëshmitarit, me të cilën është ndarë dy muaj para ngjarjes kritike. Nuk ka dashur të bisedoj me të akuzuarin, sepse kishte humbur besimin tek i njëjti, për shkak të sjelljes së tij dhe dyshimit në sinqeritetin e tij se përsëri dëshiron të jetoj me motrën e dëshmitarit. Të njëjtën ditë, nuk e di se sa ishte ora, por vonë në mbrëmje,

mori porosinë nga i akuzuari që të takohen, dhe pasi që ishte me veturë në afërsi të "Pro Credit" bankës dhe deri sa ende ishte në veturë, erdhi i akuzuari [redacted] i cili tentoi të hyj në veturë, por dëshmitari nuk e lejoi, dhe deri sa i akuzuari ishte duke e mbyllur derën e veturës, dëshmitari dëgjoi shqiptimin e fjalëve "e mbyta vëllain" nuk përmendi emër. Edhe pse dëgjoi çka tha i akuzuari, nuk besoi se vërtetë këtë e ka bërë, e largoi të akuzuarin dhe vazhdoi rrugën, e më vonë përmes televizionit kuptoi se çfarë kishte ndodhur, pikërisht më dt. 24.11.2011. Të akuzuarin [redacted] e njeh që nga viti 2003, atëherë kur motra e tij është martuar për të akuzuarin [redacted]. Të njëjtit i falën truallin prej 3 ari, të cilin me motrën e këtij e shitën për të shkuar në perëndim. Nuk e ka të njohur se i akuzuari ka vjedhur gjëra nga shtëpia e të ndj. [redacted]. Mbrëmjen kritike kur dëgjoi të akuzuarin duke i thënë se e kishte mbytur vëllain, te i akuzuari nuk vërejti gjurmë gjaku, pasi që ishte errësirë dhe për arsye se shkurt qëndroi me të akuzuarin. Sikur t'i kishte besuar Idrizit se ka privuar nga jeta vëllain e tij, me siguri se rastin do ta lajmëronte në polici.

Me provat shtjelluara materiale, me raportin mbi vëzhgimin në vendin e ngjarjes, me shikimin e bërë në skicën dhe fotoalbumin e përpiluar në vendin e ngjarjes të dt. 24.11.2011, protokollit për marrjen e kufomës, protokollit mbi konstatimin e vdekjes së të ndj. [redacted], procesverbalit mbi ekspertizën e bërë, gjegjësisht obduksionit të ndj. [redacted], leximin e faturave mbi tërheqjen e parave nga xhirollogaria e të ndj. [redacted], leximin e fl. poseduese në emër të ndjerit [redacted], të lëshuar nga ana e shërbimit kadastral në Gjilan, është vërtetuar se më dt. 24.11.2011 rreth orës 01:30 minuta në polici është lajmëruar se në shtëpinë e të ndj. [redacted] janë gjetur njolla gjaku dhe fije floku, dhe për këtë arsye dyshohej se në shtëpi kishte ndodhur krim, pasi që nga data 21.11.2011 nuk është ditur se ku gjendet pronari i shtëpisë, tani i ndj. [redacted]. Gjatë vëzhgimit është vërejtur se kufoma e të ndj. [redacted] gjendet në pusin që ndodhet në oborr, ku jetonte i ndjeri. Me rastin e vëzhgimit, është përpiluar skica e renditjes së dhomave në shtëpi, si dhe vendi ku janë gjetur gjurmët e gjakut, nëpër mur dhe dysheme. Në procesverbalin mbi vëzhgimin në vendin e ngjarjes janë konstatuar të gjitha provat, të cilat janë gjetur në shtëpinë e të ndj. Sadri Hajrizi, si dhe në shtëpinë e tani të akuzuarit [redacted], te i cili është bërë vëzhgimi, pas njoftimit për vrasjen e të ndj. [redacted]. Në procesverbal janë konstatuar të gjitha ato që janë gjetur në shtëpinë e të ndjerit dhe shtëpinë e të akuzuarit, dhe çka është konfiskuar me rastin e vëzhgimit. Nga procesverbali mbi obduksionin është vërtetuar se i ndjeri ka pësuar dy goditje në pjesën e kokës, në pjesën e pasme, dhe atë: një goditje në distancë prej 1 cm nga vija e mesme kokës dhe 15 cm deri te veshi i majtë, lëkura është prerë në formë të shkronjës "V" me çrregullim të buzëve të përgjakura, kurse në thellësi të plagës vërehen urëzat e indeve, ky dëmtim pra paraqet plagë prerëse, e shkaktuar me veprim mekanik të mjetit të rëndë

dhe të fortë. Dëmtime të ngjashme ndodhen edhe në pjesën e majtë të regjionit të pasmë të kokës, në një distancë prej 2 cm nga vija e mesme e kokës, ekziston lëndimi në formë të zgjatur me prerje buzë të përgjakura, ndërsa në thellësi të plagës vërehen urëzat e indeve, gjatësia e këtij dëmtimi është rreth 5 cm. Shkaktar i vdekjes është pasoja nga gjakderdhja masive në pjesën e fortë dhe të butë të bërthamës së trurit, dhe dëmtimit të indit trunor, për shkak të veprimit me mjet të fortë mekanik, pra, për këtë arsye ka ardhur deri te vdekja. Pas nxjerrjes së kufomës nga pushi është konstatuar vdekja, kjo nga raporti mjekësor i Dr. [] , doktor i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë, dhe se gjurmët e gjetura të gjakut dhe flokut i përgjigjen profilit të ADN të ndj. [] .

Me shikimin e bërë në fotodokumentacionin e përpiluar në vendin e ngjarjes me rastin e vëzhgimit në shtëpinë e të ndjerit dhe shtëpinë e të akuzuarit, është vërtetuar vendi ku i ndjeri ka pësuar lëndimet trupore nga të cilat ka pasuar vdekja, se kufoma është gjetur në pus si dhe fotodokumentacioni i kufomës deri sa ishte në pus, gardëroba të cilën i akuzuari e gjuajti në kontejner pas kryerjes së vrasjes, gjegjësisht, në ujë, në një qese najloni përskaaj lumit “Dobrusha”.

Në bazë të cekurave të mësipërme gjykata konstaton se në veprimet e të akuzuarit përmbahen të gjitha elementet qenësore të veprës penale vrasja e rëndë nga neni 147 paragr.1 pika 3 KPK dhe se nuk ka rrethana të cilat do të kishin përjashtuar përgjegjësinë penale të akuzuarit.

Në bazë të provave të shtjelluara si dhe me pranimin e pjesshëm të akuzuarit është vërtetuar se i akuzuari ditën kritike më dt. 21.11.2011 në orët e mbrëmjes ka shkuar në oborrin dhe shtëpinë e tani të ndj. Sadri Hajrizi dhe me të njëjtin ka filluar bisedën lidhur me pronën dhe kthimin e të akuzuarit në shtëpinë në të cilën jetonte tani i ndj. [] . Pas bisedës që zhvilluan mes veti në njërin nga dhomat e shtëpisë së të ndjerit, i akuzuari ka marr sëpatën e cila ishte në shtëpi dhe me të njëjtën, përderisa i ndjeri ishte i kthyer me shpinë kah i akuzuari, ka goditur dy herë të ndjerin në pjesën e pasme të kokës duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore nga të cilat lëndime ka pasuar vdekja. Pas goditjeve të shkaktuara, i akuzuari së pari vendosi najlon në pjesën ku ishin plagët në kokën e të ndjerit, pastaj e ka ngritur dhe tërhequr nëpër shtëpi deri në oborr, e pastaj deri te pushi që gjendet në oborr, dhe të njëjtin e ka hedhur në pus. Pas kësaj i akuzuari e ka mbyllur derën me çelës dhe ka shkuar në banesën ku jetonte para vrasjes, ka zhveshur gardërobën që kishte të veshur dhe të njëjtën e ka paketuar në qese dhe e ka gjuajtur në ujë e lumit “Dobrusha”, ku edhe është gjetur qesja. Pasi që i akuzuari kishte gjuajtur gardërobën e vet, të cilën e kishte të veshur me rastin e kryerjes së vrasjes, është nisur në drejtim të qytetit dhe rrugës takoi vëllain e gruas së tij – pa kurorë, [] , i cili punon si vozitës i

taksisë, duke i thënë të njëjtit se ka vrarë vëllain, përderisa dëshmitari nuk e ka pranuar në veturën e tij taksi, sepse konsideronte si e akuzuari dëshiron të bisedoj lidhur me vazhdimin e jetës së përbashkët me bashkëshorten e tij pa kurorë, me motrën e dëshmitarit të dëgjuar. Pasi që i ndjeri jetonte i vetëm në shtëpi, kurse anëtarët e familjes së tij të ngushtë ishin në Gjermani, të njëjtit disa herë kanë thirr me telefon të ndjerin, por përgjigje nuk kishte, dhe për këtë arsye e thirrën [redacted], e lutën që të verifikoj se çfarë ka ndodhur me [redacted], pasi që i njëjti i informoi se shtëpia ishte e mbyllur me çelës dhe se askush nuk përgjigjet nga shtëpia, e të afërmit e tij kërkuan nga Labinoti që të lajmëroj policinë për zhdukjen e të ndjerit. Pas lajmërimit, më dt. 24.11.2011, pjesëtarët e policisë dolën në vendin e ngjarjes të shtëpia e të ndjerit, në prezencë të dëshmitarit thyen derën e hyrjes së shtëpisë, ku gjetën gjurmë se në shtëpi është kryer krimi. Duke i përcjellë gjurmët, pjesëtarët e policisë gjetën trupin, të hedhur në pusin që gjendet në oborr. Pas kësaj, trupi është nxjerrë nga pusi, është kontrolluar nga mjeku i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë dhe është dërguar për obduksion.

Gjykata nuk pranoi pjesën mbrojtëse të akuzuarit se gjatë zhvillimit të bisedës, tani i ndjeri Sadri e kishte fyer dhe sharë, dhe se për këtë dhe për shkak të kundërshtimit të ndjerit, që ta pranoj përsëri në shtëpi dhe t'i jep pjesën e tij të pasurisë që i takon, mori sëpatën e cila ishte në korridor të shtëpisë dhe pasi i ndjeri ktheu shpinën, i akuzuari nga pas e goditi dy herë me sëpatë. Gjykata shqyrtoi edhe deklaratat për çështjet e parregulluara pronësoro juridike në mes të ndj. [redacted] dhe të akuzuarit [redacted]. Me analizimin e atyre provave dhe deklaratave, gjykata gjeti se çështjet pronësoro juridike nuk ishin të rregulluara, kurse i ndjeri, pasi që vëllezërit e tij, pas vdekjes së prindërve të tyre, me kërkesë të ndjerit për të ndërtuar shtëpi, kanë braktisur shtëpinë e re dhe të gjithë kanë shkuar të banojnë privatisht, pas ndërtimit të shtëpisë së re, i ndjeri pasurinë që e kishin në fsh. Uglarë dhe pasurinë në të cilën e ndërtoi shtëpinë në Gjilan, ku paraprakisht ishte shtëpia e vjetër, në të cilën jetonin të gjithë dhe e cila është rrënuar për të ndërtuar shtëpinë e re, ngastrën dhe shtëpinë, në kadastër ZK Gjilan dhe ZK Uglarë, i ka regjistruar në emrin e tij në vitin 2006. Para se të bëhej regjistrimi, pas vdekjes së babait të tyre [redacted] nuk është zhvilluar procedurë trashëgimore e as që ekziston ndonjë kontratë për lënie - transferim të pasurisë pas vdekjes. Pavarësisht marrëdhënieve të parregulluara pronësore në mes të vëllezërve dhe trashëgimtarëve pas vdekjes së të ndj. [redacted] nga fsh. Uglarë-Gjilan, i akuzuari ka pasur mundësi që me procedurë gjyqësore të kërkoj shqyrtimin e trashëgimisë dhe vërtetimin e pronësisë mbi pasurinë, për të cilën ka konsideruar se e ka të drejtën në pronësi dhe trashëgimi, e jo me konflikt, fjalosje dhe përdorimin e sëpatës të zgjidhë problemin.

Gjykata konstaton, në bazë të gjitha provave të shtjelluara, se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të elementet qenësore të veprës penale vrasja e rëndë nga neni 147.paragr.1 pika 3 KPK, e jo siç është cekur në aktakuzën e ushtruar dhe në procesverbalin mbi ndryshimin e aktakuzës, se bëhet fjalë për veprën penale vrasja e rëndë nga neni 147.paragr.1 pika 7 KPK.

Në të vërtetë, me provat e shtjelluara gjatë procedurës, nuk është argumentuar se i akuzuari [redacted] pas kryerjes së veprës penale ka bastisur gardërobën në trupin e të ndjerit dhe se nga xhepi i tij ka marr 4.000 €. Gjatë procedurës i akuzuari e ka mohuar këtë fakt se nga i ndjeri ka marr 4.000, orën e dorës "Armani" telefonin celular dhe çelësat e veturës, përveç asaj se i ka marr 20 €, të cilat ishin mbi tavolinë, në dhomë. Gjatë procedurës të dëmtuarit pohuan se i ndjeri me veti kishte shumë e parave prej 3.000-5.000 €, dhe se djali [redacted] ka tërheqë para nga llogaria e tij në Gjermani, të cilat ia ka sjell babait tani të ndjerë kur vinte në Gjilan. Duke pasur parasysh se është e pakontestueshme, e në bazë të deklaratave të dëmtuarve se në gardërobën e të ndjerit pas marrjes së kufomës, janë gjetur 500 € dhe kartela e bankës, e në pus ora e dorës, vetvetiu, dhe në bazë të deklaratave të dëmtuarve dhe pohimit të tyre se kanë sjell para dhe ia kanë dhënë të ndjerit, nuk është e mjaftueshme, për t'u argumentuar se i akuzuari për shkak të përfitimit të kundërligjshëm pasuror, ka privuar nga jeta të ndjerin. Gjykata në mungesë të provave, se i akuzuari pas vrasjes ka bastisur gardërobën në trupin e të ndjerit dhe ka marr 4.000 €, nuk ka mundur ta pranoj si të argumentuar, se i akuzuari në gardërobën e tij ka pasur atë shumë të parave dhe se ato të holla i ka marr i akuzuari. Se i akuzuari vërtetë e ka kontrolluar gardërobën e të ndjerit, me siguri do t'i gjente edhe 500 € dhe kartelën e bankës, të cilat janë gjetur tek i ndjeri pas marrjes së kufomës. Pasi nuk pati prova të mjaftueshme, se i akuzuari pas vrasjes ka bastisur dhe kontrolluar gardërobën e të ndjerit, gjykata nuk mundi të pranoj se i akuzuari ka privuar nga jeta të ndjerin për përfitim pasuror material, e paraparë me nenin 147.paragr.1 pika 7 KPK. Duhet pasur parasysh mënyrën e kryerje së kësaj vepre penale, pra se i akuzuari [redacted] atëherë kur i ndjeri ishte i kthyer me shpinë kah ai, ka marr sëpatën e cila ishte në korridor, dhe deri sa i ndjeri gjendej në njërin nga dhomat e shtëpisë ku ai jetonte, me pjesën e topitur të sëpatës e ka goditur në pjesën e pasme të kokës dhe në pjesën e qafës. Me goditje dhe shkaktimin e tyre viktimës pas shpine, mund të trajtohet si e kualifikuar dhe si vrasje në mënyrë tinëzare. Tinëzia pasqyrohet në atë se i akuzuari, atëherë ku i ndjeri ishte i kthyer me shpinë kah ai, ka vepruar me sëpatë, duke i shkaktuar të ndjerit dy goditje nga të cilat ka pasur vdekja. Tinëzia e të akuzuarit pasqyrohet në faktin se i akuzuari pas goditjeve, i ka marr dorëzat të cilat i gjeti në shtëpi, të ndjerit i ka vu qesen e najlonit në pjesët ku ishin shkaktuar lëndimet, e ka nxjerr nga shtëpia dhe e ka hedhur ne pus, i cili gjendet në oborrin, ku edhe është gjetur i ndjeri pas

tre ditësh. Gjykata konsideron se është plotësuar elementi subjektiv dhe objektiv, se bëhet fjalë për veprë penale të kryer në mënyrë brutale dhe finëzare. Gjykata konstaton se brutaliteti pasqyrohet me atë se i akuzuari pas goditjeve të bëra ka menduar dhe ka kërkuar mënyrë që kufomën gjegjësisht trupin e të ndjerit ta largoj nga shtëpia, kështu në mënyrën e lartcekur, trupin e të ndjerit e ka hedhur në pus.

Nga arsyet e cekura më lart, gjykata konstaton se bëhet fjalë për kualifikimin juridik, e në bazë të provave të shtjelluara, se i akuzuari ka kryer vrasje të rëndë të paraparë me nenin 147.paragr.1 pika 3 KPK, e jo veprën penale nga neni i njëjtë dhe paragr.7, nga arsyet se nuk është argumentuar në mënyrë të sigurt se i akuzuari ka kryer veprën për shkak të përfitimit material e pasuror.

Me rastin e vendosjes mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata të akuzuarve u vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 64 KPK ndikojnë që dënimi të jetë më i lartë apo më i ulët. Gjykata, në anën e të akuzuarit si rrethana lehtësuese mori parasysh, pa ndonjë ndikim të madh në llojin dhe lartësinë e dënimit, faktin se i ndjeri ia ka mohuar kthimin në pronësi, ku ka jetuar edhe më herët edhe në shtëpi të re, e cila është ndërtuar nga ana e të ndjerit dhe se marrëdhëniet pronësoresh juridike nuk ishin të spastruara në tërë familjen. Si rrethana rënduese gjykata të akuzuarit i mori parasysh faktin se i akuzuari e ka ditur se i ndjeri është vet në shtëpi, se anëtarët e familje së tij të ngushtë janë jashtë vendit, se pa ftesë ka shkuar te shtëpia e të ndjerit, se ka filluar bisedën lidhur me ndarjes e pasurisë dhe rregullimit të çështjeve pronësoresh-juridike, se së pari kishte sulme të ndërsjella verbale, e duke shfrytëzuar rastin kur i ndjeri ktheu shpinën, të njëjtin e ka goditur me sëpatë, atëherë kur i ndjeri nuk ka pasur kurrfarë mundësie të mbrohet, se pas goditjeve ka ndërmarr veprime tjera, për të larguar trupin e të ndjerit, ku trupin e tij e ka hedhur në pus, e ka mbyllur pusin me kapak dhe pa kurrfarë brejtje ndërgjegjeje ka dal nga shtëpia e të ndjerit dhe ka mbyllur me çelës, e krimi është zbuluar tre ditë pas kryerjes, se gjatë asaj kohe trupi i të ndjerit ka qëndruar në pus, e i akuzuari lirisht ka qarkulluar nëpër qytet.

Në bazë të cekurave të mësipërme, gjykata gjen se me dënimin e shqiptuar të burgut afatgjatë në kohëzgjatje prej nga 25 (njëzetepesë) viteve, do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 34 të KPK. Fillimisht mund të pritët se dënimi i burgut afatgjatë do të ndikoj te i akuzuari, se i njëjti do të ketë ndikim edukues tek të tjerët që të mos kryejnë vepra penale si dhe do t'i kontribuoj disiplinës dhe përgjegjësisë më të lartë të qytetarëve.

Gjykata në bazë të nenit 393.paragr.5 dhe 6 KPPK, lidhur me nenin 73 KPK, të akuzuarit në shqiptimin e dënimit me burg i llogariti kohën e

kaluar në paraburgim prej dt. 24.11.2011 deri në plotfuqishmëri të aktgjyqimit, por jo më gjatë se deri në skadimin e kohëzgjatjes së dënimit të shqiptuar me aktgjykim të shkallës së parë.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmt. në kontestin civil, për realizimin e kërkesës pronësoro – juridike, është marr në bazë të nenit 112 lidhur me nenin 108 par.1 KPPK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marr në bazë të nenit 99. lidhur me nenin 102. të KPPK.

GJYKATA E QARKUT NË GJILAN
Më dt. 28.05.2011.

Sekretarja juridike,
Verica Gavrilloviq, d.v.

Kryetari i trupit – gjyqtari,
Vllastimir Dimiq, d.v.

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të aktgjyqimit.

Përktheu – përkthyesja e gjykatës,
Najle Keçmezi

